

LIGJ
Nr. 47/2012

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS B NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “INFRASTRUKTURA BASHKIAKE II, FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET PËR QYTETET BERAT, FIER, KAMZË, KUÇOVË, LUSHNJË DHE SARANDË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas B ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake II, furnizimi me ujë dhe kanalizimet për qytetet Berat, Fier, Kamzë, Kuçovë, Lushnjë dhe Sarandë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.4.2012

Shpallur me dekretin nr. 7428, datë 30.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi